



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIM

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me qëllim të avancimit të qeverisjes lokale i fton të gjitha organizatat joqeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës, të aplikojnë për realizimin e projekteve të vogla në fushën e qeverisjes lokale. Tashmë komunat e Republikës së Kosovës e kanë një bazë të qëndrueshme të infrastrukturës ligjore, përmes të cilës OJQ-të mund të japin kontributin e tyre në avancimin e mëtutjeshëm të modaliteteve qeverisëse, në të mirë të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. MAPL-ja vlerëson se përmes ndarjes së këtyre granateve, t'u mundësojë përfaqësuesve të komunave të jenë sa më afër ideve novatore të shoqërisë civile, të cilat, gjithnjë në harmoni me legjislacionin gjegjës, sugjerojnë dhe praktikojnë ide më pragmatike në të mirë të avancimit të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Projekti duhet të realizohet gjatë vitit fiskal 2014.

Kërkesat (Projekt-propozimet) duhet të përmbajnë:

1. Projekt-propozimin;
2. Buxhetin e detalizuar, si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;
3. Afatin (dinamik) kohor për implementim;
4. Përshkrimin e detalizuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës (*personeli, pajisjet dhe aftësitë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete, etj*);
5. Një kopje që dokumenton regjistrimin e OJQ-së/ve, konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës;
7. Referencat për punë të ngjashme;

8. Aplikantët duhet të kenë xhirollogari në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Të gjithë të interesuarit për aplikim mund të marrin informata në Departamentin për Transparencë dhe Përformancë Komunale në MAPL, përmes tel: 038 200 35 509 , ose në uebfaqen e MAPL-së: <http://www.mapl-ks.org>

Propozimet e kompletuara e të mbyllura në zarf mund të dorëzohen në zyrat e Departamentit të Performances dhe Transparencës Komunale në MAPL ish-“Rilindja”, kati X. Data e fundit për aplikim është deri më 25 mars 2014, në ora 14:00.